




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. nr. 349/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje: z. Goran Milenković – Kryetar, z. Nuhi Paçarizi – Referues, z. Blerim Dina – Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik “NNP Arhiko. ing”, kundër njoftimit dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Hartimi i projekteve” me numër prokurimi 615-19-1401-221 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës, më datën 24 korrik 2019, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “NNP Arhiko. ing”, kundër njoftimit dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull prokurimit: “Hartimi i projekteve” me numër prokurimi 615-19-1401-221 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës.

II. VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve” me numër prokurimi 615-19-1401-221 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Komuna e Podujevës.

IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

V. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VII. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Data e njoftimit për kontratë: 25.03.2019

Lloji i procedurës së aplikuar: Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: Kontratë publike shërbime/mesme

Vlera e parashikuar e kontratës: 60.000,00 €

Kriteri për dhënie të kontratës (N. 52): çmimi më i ulët

Data e hapjes së ofertave: 15.04.2019

Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave: 11.06.2019

Data e njoftimit me letër standarde për tenderues të eliminuar apo të pa suksesshëm: 11.06.2019

Data e njoftimit për dhënie të kontratës: 11.06.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim: 17.06.2019

Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: 18.06.2019

Me datën 27. 06. 2019 OE NNP “Arhiko.ing”- Prishtinë ka parashtruar ankesën me nr. 349/19 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Hartimi i Projekteve” me nr. prok. 615-19-1401-221, iniciuar nga autoriteti kontraktues Komuna e Podujevës. Dispozitat që OE ankues pretendon se janë shkelur janë:

- Neni 7 i LPP-së (Barazia në trajtim-Jo/diskriminimi)
- Neni 10 i LPP-së (Mjetet për promovimin e transparencës)
- Neni 11 i LPP-së (Informatat Sekrete Afariste)
- Neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)
- Neni 65 i LPP-së (Pranueshmeria e kandidateve dhe tenderuesve)
- Neni 66 i LPP-së (Përshtatshmëria profesionale)
- Neni 69 i LPP-së (Aftësitë teknike dhe/ose Profesionale)
- Neni 33 i RRUOPP- Dorëzimi elektronik i tenderëve

- Neni 3.12 i RRUOPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 02. 07. 2019 ka autorizuar ekspertin shqyrtues profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore, i cili në raportin e datës 05 korrik 2019 ka konstatuar:

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së (Mjetet për promovimin e transparencës) dhe nenit 11 të LPP-së (Informatat sekrete afariste) sepse gjatë procesit të qasjes në dokumentet e OE fitues nuk ka garantuar transparencë duke e shpallë dokumentacionin e kompanisë fituese si dokument sekret afarist pa i plotësuar kushtet e parapara në këtë nen, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Operatori ekonomik ankues me datën 11.06.2019 ka kërkuar nga AK ti ofroj qasje në dokumentet e ofertës së OE fitues. Autoriteti kontraktues këtë qasje ja ka ofruar me datën 12.06.2019 OE ankues në dokumentet e ofertës së OE fitues. Pra sipas nenit 10 të LPP-së qasja i është dhënë OE ankues. Mirëpo autoriteti kontraktues ka bërë një klasifikim të dokumenteve të ofertës së OE fitues në përputhje me nenin 11 paragrafi 3 të LPP-së, të cilat dokumente kanë të bëjnë me kërkesat e nenit 68 dhe 69 të LPP-së dhe në këto dokumente nuk ju ka dhënë qasja OE ankues.

Qasja në këto dokumente nuk i është dhënë OE ankues për shkak se OE fitues ka plotësuar kërkesën sipas Aneksit 3 të dosjes së tenderit dhe në këtë kërkesë është theksuar që autoriteti kontraktues këto dokumente ti mbaj si sekret afarist i kompanisë.

Veprimi i autoritetit kontraktues në këtë rast është në përputhje me nenin 11 paragrafi 3 i LPP-së

Qëndrim të njëjtë ka mbajtur edhe KRPP-ja në përgjigjen e pyetjes që i është bërë nga OE ankues lidhur me klasifikimin e dokumentacionit sekret afarist.

KRPP në kuadër të përgjigjeje së datë 20.06.2019 që i kthen OE ankues për këtë çështje ndër të tjera thotë:

“Informatat sekrete afariste mund të kërkojnë që të klasifikohen nga AK vetëm dëshmitë e ofruara lidhur me kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare dhe dëshmitë lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale por asesi e gjithë oferta”

Nga kjo dëshmohet se AK ka pasur të drejtë që i ka klasifikuar dokumentet e OE fitues, që kanë të bëjnë me aftësitë teknike dhe/ose profesionale (referencat, listën e projekteve, listën e punëtorëve, diplomat etj.) pra që lidhen me kërkesat e neni 68 dhe 69 të LPP-së siç e parasheh neni 11 i LPP-së për informata

sekrete afariste, ndërsa qasja është dhënë në dokumentet e tjera të ofertës. Nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Përgjigje në Pretendimin 2.

Sa i përket pretendimit tjetër ankimor se OE me radhë "Studio Hapësira" nuk i plotëson kërkesat e pikës 9.1 & 9.2 të FDT që lideri i konzorciumit duhet të ketë 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Gjatë shqyrtimit të ofertës së OE "Studio Hapësira" shihet se me ofertë ka të bashkangjitur listën e projekteve të realizuara të natyrës së ngjashme me projektin e AK-së. Lista e projekteve të ofruara e përmbushën kërkesat e pikës 9.1 & 9.2 të FDT. Shumica e kontratave të realizuara nga ky Operator Ekonomik janë pikërisht në hartimin e projekteve. Lista e projekteve me referenca dhe raporte të pranimit të punimeve të OE "Studio Hapësira" është e bashkangjitur edhe në platformën elektronike që lehtë mundet të verifikohet. Po ashtu në platformë elektronike është e bashkangjitur edhe lista e stafit sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Pra ky kusht është i plotësuar. Edhe po të ishte kjo oferte e pa përgjegjshme nuk do të kishte ndonjë ndikim në këtë aktivitet të prokurimit sepse oferte OE të rekomanduar për kontratë është e përgjegjshme dhe ka ofruar çmimin më të ulët. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët. Oferta e OE ankues është oferta e 3 me radhë për nga çmimi sipas kriterit të dhënies së kontratës. Pra edhe dy oferta kanë çmim më të ulët se oferta e OE ankues.

Gjatë procesit të ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Qasja në dokumentet e OE fitues i është dhënë OE ankues por në dokumentacion të klasifikuar që AK e ka bërë sipas kërkesës së plotësuar të Aneksit 3 të dosjes së tenderit nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Në këtë proces të vlerësimit, nuk ka shkeljet të neneve të LPP-së të përmendur në ankesë nga operatori ekonomik ankues.

Bazuar në sqarimet e dhënë më lartë në përgjigjeje e pretendimeve ankimor të OE ankues, eksperti shqyrtues e refuzon ankesën si të pa bazuar.

Eksperti shqyrtues në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së rekomandon autoritetin kontraktues të vazhdoj me dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit "Hartimi i Projekteve" me nr. prok. 615-19-1401-221 në përputhje me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik.

Operatori ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05 korrik 2019, ka njoftuar panelin shqyrtues se nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 05 korrik 2019, ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 24. 07. 2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues dhe operatorit ekonomik ankues, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues profesional, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë të OE ankues deklaroi: "Po prezantojmë ne pika të shkurta duke filluar prej mendimit të ekspertit ku thotë gjatë procesit të ekzaminimit që KK-Podujeve ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Ne ankesën që kemi bërë nënë janë shkelur nenet të cilat i kemi cekur në ankesë. Pika e 2-të është shkel nënë 69 nga ana e Autoriteti Kontraktues. Po ashtu janë shkel rregullat udhëzuese 39.8, RrUOPP-së, OE i rekomanduar për kontratë ka shkel edhe nenin 13 ka dorëzuar diplome jo në gjuhën zyrtare në Kosovë. Ne si OE ankues nuk kemi pasur qasje në dokumente zyrtare të OE të rekomanduar për kontratë. Po ashtu edhe nënë 61 është shkelur nga Autoriteti Kontraktues".

Në vazhdim fjalë iu dha përfaqësuesit të AK-së z. Fejza i cili deklaroi: Ne si Autoriteti Kontraktues mendojmë që kemi pasur të drejtë që kemi klasifikuar dokumentet e OE fitues që kanë të bëjnë me ftesit teknike dhe profesionale, referencat lista e punëtorëve, këtu që janë lidhur me kërkesat e nenit 68 dhe 69, siç e parash nënë 10 dhe 11 të LPP-së për informata sekrete afariste, ndërsa OE ankues ju është dhënë qasje në dokumente të tjera por i cili nuk i ka dashtë ato. Mendojmë që Autoriteti Kontraktues ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Prandaj ky pretendim ankimor mendojmë që është i pabazuar për arsye që ne si Autoriteti Kontraktues qëndrojmë prapa mendimit të ekspertit shqyrtues. OE i rekomanduar është plotësisht në rregull me dokumentet e ofruara sipas kërkesave të Autoriteti Kontraktues.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues z. Kurtishaj i cili deklaroj: “OE ankues ka kërkuar qasje në dokumentacion tek Autoriteti Kontraktues për ofertën e OE të rekomanduar për kontratë. AK ka bërë një klasifikim të dokumenteve të OE fitues për shkak se i njëjti plotësuar aneksin 3 të DT-së për dokumente sekrete afariste. Neni 11 paragrafi 3 i LPP-së shume qarte e precizon se cilat dokumente mund të jenë sekrete afariste. Mbi këtë bazë Autoriteti Kontraktues i ka ndare sipas kërkesës së OE të rekomanduar për kontratë dhe nuk i ka dhënë qasje OE ankues. Veprimi i Autoriteti Kontraktues për këtë rast ka qenë në përputhje të plotë me nenin 11 paragrafi 3. Në lidhje me këtë çështje OE ankues ka kërkuar interpretim nga KRPP dhe të njëjtën përgjigje ka marrë nga KRPP. Pretendim tjetër i ngritur i OE ankues ka qenë lidhur me një OE të dytë me radhë pas fituesit për të cilin ka pretenduar se edhe ky OE nuk i ka plotësuar pikat 9.1 dhe 9.2 të DT, mirëpo i njëjti i plotëson kërkesat e nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT-së prandaj të dy pretendimet e OE ankues janë të pa bazuara parkete arsye i kam dhënë të drejtë AK që të vazhdojë me shenjen e kontratës të lartcekur”.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues që të aprovohet ankesa jone si e bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Kërkojmë që ankesa e OE ankuese të refuzohet si e pabazuar dhe të vazhdojmë me aktivitetin e prokurimit me dhënie të kontratës.

Paneli shqyrtues pas analizimit dhe shqyrtimit të pretendimeve ankimore, deklarimeve në seancën për shqyrtim kryesor, shoshitjes së provave dhe fakteve, analizës së raportit të ekspertit shqyrtues profesional, lidhur me pretendimin ankimor të operatorit ankues se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 10 të LPP-së (Mjetet për promovimin e transparencës) dhe nenit 11 të LPP-së (Informatat sekrete afariste) sepse gjatë procesit të qasjes në dokumentet e OE fitues nuk ka garantuar transparencë duke e shpallë dokumentacionin e kompanisë fituese si dokument sekret afarist pa i plotësuar kushtet e parapara në këtë nen, konstatoj se operatori ekonomik ankues me datën 11. 06. 2019, ka kërkuar nga AK të ofroj qasje në dokumentet e ofertës së OE fitues. Autoriteti kontraktues këtë qasje ja ka ofruar me datën 12. 06. 2019, OE ankues në dokumentet e ofertës së OE fitues. Pra sipas nenit 10 të LPP-së qasja i është dhënë OE ankues. Mirëpo autoriteti kontraktues ka bërë një klasifikim të dokumenteve të ofertës së OE fitues në përputhje me nenin 11 paragrafi 3 të LPP-së, të cilat dokumente kanë të bëjnë me kërkesat e nenit 68 dhe 69 të LPP-së dhe në këto dokumente nuk ju ka dhënë qasje OE ankues.

Qasja në këto dokumente nuk i është dhënë OE ankues për shkak se OE fitues ka plotësuar kërkesën sipas Aneksit 3 të dosjes së tenderit dhe në këtë kërkesë është theksuar që autoriteti kontraktues këto

dokumente ti mbaj si sekret afarist i kompanisë. Veprimi i autoritetit kontraktues në këtë rast është në përputhje me nenin 11 paragrafit 3 i LPP-së. Po ashtu edhe KRPP-ja në përgjigjeje e pyetjes që i është bërë nga OE ankues lidhur me klasifikimin e dokumentacionit sekret afarist, ka shprehur këtë mendim.

KRPP në kuadër të përgjigjeje së datë 20.06.2019 që i kthen OE ankues për këtë çështje ndër të tjera thotë: *“Informatat sekrete afariste mund të kërkohen që të klasifikohen nga AK vetëm dëshmitë e ofruara lidhur me kërkesat për gjendjen ekonomike dhe financiare dhe dëshmitë lidhur me aftësitë teknike dhe/ose profesionale por asesi e gjithë oferta”*

Nga kjo dëshmohet se AK ka pasur të drejtë që i ka klasifikuar dokumentet e OE fitues, që kanë të bëjnë me aftësitë teknike dhe/ose profesionale (referencat, listën e projekteve, listën e punëtorëve, diplomat etj.) pra që lidhen me kërkesat e neni 68 dhe 69 të LPP-së siç e parasheh neni 11 i LPP-së për informata sekrete afariste, ndërsa qasja është dhënë në dokumentet e tjera të ofertës. Nga kjo rezulton se autoriteti kontraktues i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Prandaj ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Sa i përket pretendimit tjetër ankimor se OE me radhë “Studio Hapësira” nuk i plotëson kërkesat e pikës 9.1 & 9.2 të FDT që lideri i konzorciumit duhet të ketë 60% të shumës së kërkuar në punë të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit, paneli shqyrtues vlerëson se gjatë shqyrtimit të ofertës së OE “Studio Hapësira” shihet se me ofertë se ka të bashkangjitur listën e projekteve të realizuara të natyrës së ngjashme me projektin e AK-së. Lista e projekteve të ofruara e përmbushën kërkesat e pikës 9.1 & 9.2 të FDT. Shumica e kontratave të realizuara nga ky Operator Ekonomik janë pikërisht në hartimin e projekteve. Lista e projekteve me referenca dhe raporte të punimeve të OE “Studio Hapësira” është e bashkangjitur edhe në platformën elektronike që lehtë mundet të verifikohet. Po ashtu në platformë elektronike është e bashkangjitur edhe lista e stafit sipas kërkesave të dosjes së tenderit. Pra ky kusht është i plotësuar. Edhe po të ishte kjo oferte e pa përgjegjshme nuk do të kishte ndonjë ndikim në këtë aktivitet të prokurimit sepse oferte OE të rekomanduar për kontratë është e përgjegjshme dhe ka ofruar çmimin më të ulët. Prandaj edhe ky pretendim ankimor është i pa bazuar.

Autoriteti kontraktues ka rekomanduar për kontratë ofertën e përgjegjshme me çmimin më të ulët. Oferta e OE ankues është oferta e 3 me radhë për nga çmimi sipas kriterit të dhënies së kontratës. Pra edhe dy oferta kanë çmim më të ulët se oferta e OE ankues.

Gjatë procesit të ekzaminimit vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve autoriteti kontraktues i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së. Qasja në dokumentet e OE fitues i është dhënë OE ankues por në dokumentacion të klasifikuar që AK e ka bërë sipas kërkesës së plotësuar të Aneksit 3 të dosjes së tenderit

nga operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë. Paneli shqyrtues vlerëson së ekzaminimi dhe vlerësimi i ofertave është bërë konform dispozitave të LPP-së dhe nuk ka shkelje të dispozitave nga AK ashtu siç ka pretenduar OE ankues.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 OE- "Arhiko ING"

1x1 AK- KK Podujeve

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.